



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA

PRIVATIZIMI NË SEKTORËT JO STRATEGJIK NË SHQIPËRI SI THEMELI I INTEGRIMIT NË BE

PhD. Endri Papajorgji

Abstrakt:

Procesi i privatizimit pas viteve 90-të ka hedhur themelin bazë për integrimin e Shqipërisë në BE, jo vetëm në fushën ekonomike, por edhe atë juridike. Në fund të viteve 80-të një sistem ideologjik, politik, ekonomik dhe social u shpërbë dhe në Shqipëri, si në të gjitha shtetet e Europës lindore, demokracia, ekonomia e lirë e tregut dhe shteti i së drejtës, të bazuar në pronën private dhe lirinë ekonomike, ishin themeli i këtij transformimi. Por mënyra se si do të kryhej ky transformim nuk ishte e përcaktuar qartazi. Për më shumë se 40 vjet, shtetasit shqiptarë ishin përballur me ideologjinë komuniste si baza e rregullimit të pushtetit shtetëror. Kjo ishte e bazuar në atë, se të gjithë qytetarët gjatë socializmit kishin kontribuar në të njëjtën masë për ndërtimin e pronës shtetërore dhe shoqërore. Në Shqipëri, ashtu sikurse në të gjithë shtetet e tjera të Evropës lindore, të ashtuquajturit „Rent seekers“ u shndërruan në Oligarkë dhe pronarë të mëdhenj dhe privatizuan pronën shtetërore për pak të ardhura. Në këtë kuadër ky proces u shoqërua me mungesën e statistikave të sakta ekonomike dhe mungesën e hartimit të strategjive të privatizimit, mungesën e investitorëve të huaj, një politikë të keqe zbatuese si dhe vonesa në kuadër të reformave të nevojshme në mënyrë të menjëhershme.¹ Në themel të analizës së këtij artikulli qëndron privatizimi në Shqipëri si baza e integrimin në BE.

Fjalë kyçe: *Privatizim, ekonomi, Ligj, Shqipëri, BE.*

¹ Åslund, How capitalism was built – The Transformation of Central and Eastern Europe, Russia, the Caucasus and Central Asia² (2013) 2.